



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 07.12.2022

Nr: 220

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT TË ZGJEDHËSVE,  
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “g”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V E N D O S:**

1. Miratimin e programit për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 07.12.2022 Nr: 220  
Ora: 11:00



“Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”



# PROGRAMI PËR EDUKIMIN, INFORMIMIN DHE NDËRGJEGJËSIMIN E ZGJEDHËSVE

ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

2023



**VOTO TË DËGJOHESH!**

ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

14 MAJ 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

<b>Përmbledhje Ekzekutive .....</b>	<b>5</b>
1. Struktura e Programit .....	6
2. Sfidat e Programit .....	7
<b>PJESA E PARË: .....</b>	<b>8</b>
A. Media online .....	8
B. Rrjete sociale .....	9
C. Materiale promocionale .....	9
<b>PJESA E DYTË .....</b>	<b>10</b>
D. Spotet Televizive .....	10
E. Spote Radiofonike .....	11
F. Media online .....	11
G. Media Sociale .....	11
H. Materiale Promocionale .....	12
<b>PJESA E TRETË .....</b>	<b>13</b>
A. Spotet Televizive .....	13
B. Spote Radiofonike .....	14
C. Media online .....	14
D. Rrjete Sociale .....	15
E. Materiale Promocionale .....	16
<b>PJESA E KATËRT .....</b>	<b>17</b>
A. Spotet Televizive .....	17
B. Materiale Promocionale .....	18
<b>PJESA E PESTË .....</b>	<b>19</b>
A. Spotet Televizive .....	19
B. Media Online / rrjetet sociale .....	20
C. Materiale promocionale .....	21
<b>PJESA E GJASHTË .....</b>	<b>22</b>
A. Spote televizive .....	22
B. Spote radiofonike .....	23
C. Media Online .....	23
D. Rrjete Sociale .....	24
E. Materiale promocionale/Postera për Qendrat e Votimit .....	25
<b>PJESA E SHTATË .....</b>	<b>26</b>
A. Spotet Televizive .....	26
B. Media online .....	27
C. Rrjete sociale .....	28
E. Materiale Promocionale .....	29
<b>PJESA E TETË .....</b>	<b>30</b>
<b>MATERIALE SHITESË .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## **Përmbledhje Ekzekutive**

Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 është një plan i cili përcakton qëllimet dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve përgjatë periudhës zgjedhore.

Ky program përcakton hapat konkretë që do të ndërmerren në realizimin e objektivave, gjithashtu reflekton punën dhe angazhimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për edukimin zgjedhor të shtetasve, në përmbushje të detyrës institucionale për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuar, ku edukimi dhe informimi i zgjedhësve është ndër komponentët kryesorë garantues për arritjen e standardeve të synuara.

Zbatimi i programeve të ndryshme për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve, në një periudhë të përcaktuar kohe është një proces kompleks, sukcesi i të cilit ndërvaret edhe nga kontributi i aktorëve të tjerë që mund të bashkëveprojmë në këtë fushë.

Programi për edukimin e shtetasve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, synon ndërgjegjësimin për pjesëmarrje në votime dhe informimin e zgjedhësve mbi të gjithë procesin zgjedhor.

Programet informuese do të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit të KQZ-së me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë. Përfshirja e tyre në realizimin e programeve edukuese zgjedhore, ekspertiza, angazhimi dhe mbështetja vlerësohen si komponentë të rëndësishëm në përmbushjen e misionit të KQZ-së.

### ***Qëllimi i Programit***

Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, ka për qëllim të informojë dhe ndërgjegjësoj zgjedhësit mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor. Në mënyrë specifike programi ka si qëllim të informojë dhe edukojë zgjedhësit për datën e zgjedhjeve, në lidhje me procesin e verifikimit të emrit në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit ku zgjedhësi voton; informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi procedurën e votimit dhe identifikimit elektronik; informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve vulnerabël dhe të rinjve votues për herë të parë për pjesëmarrje; ndërgjegjësimi dhe edukimi i pakicave kombëtare; informimi i zgjedhësve mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor dhe i subjekteve zgjedhore, si dhe parandalimi i tyre.

### **Objektivat kryesore të programit janë:**

1. Informimi, ndërgjegjësim dhe edukim i zgjedhësve për datën e zgjedhjeve.
2. Informimi dhe ndërgjegjësim i shtetasve mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit;
3. Informimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre.
4. Ndërgjegjësimi i grupeve të ndryshme, votues për herë të parë, minoritetet, gratë, për rritjen e pjesëmarrjes në votime.
5. Informimi mbi financimin e partive politike;
6. Informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet;
7. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit në procesin e votimit dhe mbi mënyrën e votimit;
8. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj.

Të gjitha materialet që do të përdoren për *ndërgjegjësimin* e zgjedhësve do të përkthehen në gjuhën e pakicave kombëtare bazuar në Ligjin Nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë" neni 15, paragrafi 4.

## **1. Struktura e Programit**

Në përmbushje të objektivave kryesore, programi është i ndarë në tetë pjesë të rëndësishme, ku do të shtjellohet:

**Pjesa e parë:** Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi i zgjedhësve për datën e zgjedhjeve. Pas daljes së dekretit nga Presidenti i Republikës për mbajtjen e zgjedhjeve për vitin 2023, do të shpërndahet informacioni për zgjedhësit për datën e zgjedhjeve, për çfarë do të votohet në këto zgjedhje, si dhe informacione të përgjithshme rreth procesit zgjedhor.

**Pjesa e dytë:** Informimi dhe ndërgjegjësimi i shtetasve mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit. Çdo zgjedhës duhet të kontrollojë emrin e tij në listën e zgjedhësve dhe të verifikojë qendrën e votimit ku do të votojë. Ky proces nënkupton se çdo zgjedhës ka të drejtë të ndryshojë qendrën e tij të votimit deri 45 (dyzet e pesë) ditë para ditës së votimit dhe çdo informacion tjetër mbi listën e zgjedhësve.

**Pjesa e tretë:** Ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për rëndësinë e procesit zgjedhor, zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara. Informimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor si dhe parandalimi i tyre.

**Pjesa e katërt:** Ndërgjegjësimi i grupeve vulnerabël, të rinjve kryesisht votues për herë të parë, minoritetet, gratë, etj për të rritur pjesëmarrjen e tyre në votime. Ky program ka në fokus ndërgjegjësimin e zgjedhësve gra për të shmangur fenomenin negativ të votimit familjar në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar dhe të pandikuar, votuesit për herë të parë për rritur pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, minoritetet që jetojnë në Shqipëri që informacioni zgjedhor të shkojë tek ta në gjuhën që ata flasin, etj

**Pjesa e pestë:** Ndërgjegjësimi i subjekteve zgjedhore mbi financimin e partive politike, të ardhurat që sigurojnë për fushatën zgjedhore. Transparenca e domosdoshme e të ardhurave për fushatën, raportimi dhe monitoimi i tyre. Partitë politike kanë nevojë për financim për të përmbushur rolin e tyre, ndërkohë që mekanizmat që rregullojnë financimin e partive janë të qarta, të plota dhe të zbatueshme.

**Pjesa e gjashtë:** Informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet. Ndërgjegjësimi i punonjësve të administratës shtetërore gjatë periudhës zgjedhore dhe informimi mbi shkeljet ligjore dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre, si dhe raportimi i cdo rasti në portalin e dedikuar për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve shtetërore, para zgjedhjeve

**Pjesa e shtatë:** Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit në procesin e votimit dhe mbi mënyrën e votimit, hapat që ndjek zgjedhësi në QV së bashku me identifikimin elektronik të zgjedhësve në Qendrat e Votimit.

**Pjesa e tetë:** Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj. Zgjedhësit të jenë të përgatitur ditën e votimit për plotësimin e fletës së votimit që vota e tyre të jetë e vlefshme.

## 2. Sfidat e Programit

Sfidat kryesore të këtij programi janë realizimi brenda një kohe të shkurtër dhe implementimi i plotë në të gjitha platformat e komunikimit i programit të edukimit. Aksesit që çdo zgjedhës i Republikës së Shqipërisë të ketë në marrjen e informacionit të nevojshëm rreth procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kryetar Bashkie 2023.

Mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare për realizimin e të gjitha pjesëve të programit. Duke marrë në konsideratë afatet e ngushta kohore dhe konsensusin e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, zbatimi i këtij programi është sfidë për përmbushjen e misionit të KQZ-së.

## **PJESA E PARË:**

Informimi, ndërgjegjësimi, edukim i zgjedhësve për datën e zgjedhjeve.

### **1) Qëllimi**

Informimi dhe ndërgjegjësimi i zgjedhësve për datën e zgjedhjeve. Pas daljes së dekretit nga Presidenti i Republikës për mbajtjen e zgjedhjeve për vitin 2023, do të shpërndahet informacioni për zgjedhësit për datën e zgjedhjeve, për çfarë do të votohet në vitin 2023 si dhe informacione të përgjithshme rreth procesit zgjedhor.

### **2) Mjetet**

A. Media online

B. Rrjete sociale

C. Materiale Promocionale

#### ***A. Media online***

##### **Përmbajtja**

Zgjedhës, në 14 Maj 2023 ju do të votoni për Kryetarin e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak tuaj. Nëpërmjet votës ju do të mund të shprehni vullnetin tuaj për drejtuesin e bashkisë ku ju banoni.

Shkarkoni aplikacionin **KQZ** për Android dhe IOS ose vizitoni website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al) për të marrë të gjitha informacionet rreth zgjedhjeve në Shqipëri 2023 në kohë reale.

##### **Periudha e transmetimit**

Janar – 14 maj

##### **Portalet ku do të transmetohet**

Në të gjitha portalet me shikueshmëri të lartë të regjistruara në AKEP.



## ***B. Rrjete sociale***

Zgjedhës, në 14 Maj 2023 ju do të votoni për Kryetarin e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak tuaj. Nëpërmjet votës ju do të mund të shprehni vullnetin tuaj për drejtuesin e bashkisë ku ju banoni.

Shkarkoni aplikacionin **KQZ** për Android dhe IOS ose vizitoni website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al) për të marrë të gjitha informacionet rreth zgjedhjeve në Shqipëri 2023 në kohë reale.

### **Periudha e transmetimit**

Janar-14 Maj

### **Media sociale ku do të publikohen**

Të gjitha mediat sociale më të ndjekura!

## ***C. Materiale promociionale***

### **Përmbajtja**

Zgjedhës, në 14 Maj 2023 ju do të votoni për Kryetarin e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak tuaj. Nëpërmjet votës ju do të mund të shprehni vullnetin tuaj për drejtuesin e bashkisë ku ju banoni.

Shkarkoni aplikacionin **KQZ** për Android dhe IOS ose vizitoni website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al) për të marrë të gjitha informacionet rreth zgjedhjeve vendore 2023 në Shqipëri në kohë reale.

Lloji i materialeve promociionale që të përdoren:

**Postera/ Billboard/ City light/ LED/ Flamujt në shtylla/ Projektim 3D**

### **Periudha e transmetimit**

Dhjetor - Prill

### **Materiale që do të përdoren për edukimin e zgjedhësve**

- City light
- Billboard
- LED
- Flamujt në shtylla
- Projektim 3D
- Prodhimi I spotit, shfaqja tij në mediat sociale

## PJESA E DYTË

Informimi dhe ndërgjegjësimi i shtetasve mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit.

### 1) Qëllimi

Informimi dhe ndërgjegjësimi i zgjedhësve për verifikimin e emrit në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit ku ata do të votojnë. Veprimet që do të ndjekin zgjedhësit nëse vërejnë pasaktësi, nuk gjejnë emrin në listën e zgjedhësve, apo dëshirojnë të ndryshojnë ndonjë element në ekstraktin zgjedhor, zgjedhësit duhet t'i drejtohen me një kërkesë zyrës së Gjendjes Civile, që ndodhet brenda njësisë administrative ku ata banojnë.

### 2) Mjetet:

- A. Spote televizive
- B. Spote radiofonike
- C. Media online
- D. Rjete sociale
- E. Materiale promocionale

#### *D. Spotet Televizive*

### Përmbajtja

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Shqipëri.

- Kontrolloni emrin në listën e zgjedhësve të publikuar pranë njësisë suaj administrative, ose në aplikacionin mobile KQZ Android/IOS, ose në website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al)
- Nëse nuk keni kartë identiteti apo pasaportë, ose ju ka skaduar!
- Nëse nuk e keni emrin në listën e votuesve!
- Nëse vëreni pasaktësi në të dhënat tuaja apo qendrën e votimit!

Drejtohuni në zyrat e Gjendjes Civile!

Shkarkoni aplikacionin **KQZ** për Android dhe IOS ose vizitoni website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al) për të marr të gjitha informacionet rreth zgjedhjeve vendore 2023 në Shqipëri.

Kohëzgjatja e spotit 45 sekonda.

### Periudha e transmetimit

Janar – 14 Maj

### TV ku do të transmetohet

Në të gjitha TV e liçensuar nga AMA (kombëtare/lokale), media sociale, app të ndryshme teknologjike.

### ***E. Spote Radiofonike***

#### **Përmbajtja:**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Shqipëri.

- Kontrolloni emrin në listën e zgjedhësve të publikuar pranë njësisë suaj administrative, ose në aplikacionin mobile KQZ Android/IOS, ose në website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al)
- Nëse nuk keni kartë identiteti apo pasaportë, ose ju ka skaduar!
- Nëse nuk e keni emrin në listën e votuesve!
- Nëse vëreni pasaktësi në të dhënat tuaja apo qendrën e votimit!

Drejtohuni në zyrat e Gjendjes Civile!

Shkarkoni aplikacionin **KQZ** për Android dhe IOS ose vizitoni website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al) për të marr të gjitha informacionet rreth zgjedhjeve në Shqipëri 2023.

Kohëzgjatja e spotit 30 sekonda

#### **Periudha e transmetimit;**

Janar – 14 Maj

#### **Radio ku do të transmetohet;**

Në të gjitha radiot e licencuar nga AMA (kombëtare/lokale)

### ***F. Media online***

Trasmetimi i spoteve të realizuara dhe përshtatura për mediat online me të njëjtën përmbajtje si më sipër.

#### **Periudha e publikimit;**

Janar -14 Maj

#### **Mediat online ku do të publikohen;**

Të gjitha mediat online më të ndjekura!

### ***G. Media Sociale***

Trasmetimi i spoteve të realizuara dhe përshtatura për rrjetet sociale të institucionit me të njëjtën përmbajtje si më sipër.

#### **Periudha e publikimit;**

Janar- Maj

#### **Media sociale ku do të publikohen**

Të gjitha rrjetet sociale të KQZ!

## ***H. Materiale Promocionale***

### **Përmbajtja**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Shqipëri.

- Kontrolloni emrin në listën e zgjedhësve të publikuar pranë njësisë suaj administrative, ose në aplikacionin mobile KQZ Android/IOS, ose në website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al)
- Nëse nuk keni kartë identiteti apo pasaportë, ose ju ka skaduar!
- Nëse nuk e keni emrin në listën e votuesve!
- Nëse vëreni pasaktësi në të dhënat tuaja apo qendrën e votimit!

Drejtohuni në zyrat e Gjendjes Civile!

Shkarkoni aplikacionin **KQZ** për Android dhe IOS ose vizitoni website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al) për të marr të gjitha informacionet rreth zgjedhjeve në Shqipëri 2023.

Lloji i materialeve promocionale që të përdoren:

- 1. Postera**
- 2. Gazeta**
- 3. Fletëpalosje**
- 4. City lights**

### **Materiale që do të përdoren për edukimin e zgjedhësve**

- Postera format B2 informues, letër me lustër, shtypi 4 color
- Fletëpalosje format A3 me letër me lustër, shtypi 4 color
- Fletëpalosje format 85 x 400 mm letër me lustër, shtypi 4 color
- Gazetat, ½ e faqes së brendshme referuar ofertave të shtypit të shkruar
- City lights
- Prodhim spoti/esh, banera online
- Trasmeimi në TV/media online

## PJESA E TRETË

Informimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre.

### 1) Qëllimi:

Ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për rëndësinë e procesit zgjedhor, zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara. Informimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor si dhe parandalimi i tyre.

### 2) Mjetet:

- A. Spote televizive
- B. Spote radiofonike
- C. Media online
- D. Rrjete sociale
- E. Materiale promocionale

#### A. *Spotet Televizive*

### Përmbajtja

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Republikën e Shqipërisë. Zgjedhës shqiptarë votoni për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak, por kujdes përbën veprë penale dhe dënohet me burg:

VEPËR PENALE	DËNOHET
Fotografimi apo filmimi i votës, që ta shfaqësh tek persona të tjerë	<b>NGA 3 MUAJ - 3 VITE BURG</b>
Shitja dhe blerja e votës	<b>NGA 1-5 VITE BURG</b>
Votimi familjar, apo më shumë se një herë	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Çdo veprim që cënon zgjedhjet si: votimi pa kryer identifikimin elektronik, kanosja, falsifikimi apo dëmtimi i materialit zgjedhor	<b>NGA 3 MUAJ - 7 VITE BURG</b>

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

Kohëzgjatja e spotit 45 sekonda.

### **Periudha e transmetimit**

Janar - Shkurt

### **TV ku do të transmetohet**

Në të gjitha TV e licencuar nga AMA (kombëtare/lokale), media sociale, app të ndryshme teknologjike.

## ***B. Spote Radiofonike***

### **Përmbajtja**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Republikën e Shqipërisë. Zgjedhës shqiptarë votoni për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak, por kujdes përbën veprë penale dhe dënohet me burg:

<b>VEPËR PENALE</b>	<b>DËNOHET</b>
Fotografimi apo filmimi i votës, që ta shfaqësh tek persona të tjerë	<b>NGA 3 MUAJ - 3 VITE BURG</b>
Shitja dhe blerja e votës	<b>NGA 1-5 VITE BURG</b>
Votimi familjar, apo më shumë se një herë	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Çdo veprim që cënon zgjedhjet si: votimi pa kryer identifikimin elektronik, kanosja, falsifikimi apo dëmtimi i materialit zgjedhor	<b>NGA 3 MUAJ - 7 VITE BURG</b>

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

Kohëzgjatja e spotit 30 sekonda

### **Periudha e transmetimit;**

Janar - Shkurt

### **Radio ku do të transmetohet;**

Në të gjitha radiot e licencuar nga AMA (kombëtare/lokale)

## ***C. Media online***

### **Përmbajtja Baner/ poster**



Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Republikën e Shqipërisë. Zgjedhës shqiptarë votoni për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak, por kujdes përbën veprë penale dhe dënohet me burg:

VEPËR PENALE	DËNOHET
Fotografimi apo filmimi i votës, që ta shfaqësh tek persona të tjerë	<b>NGA 3 MUAJ - 3 VITE BURG</b>
Shitja dhe blerja e votës	<b>NGA 1-5 VITE BURG</b>
Votimi familjar, apo më shumë se një herë	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Çdo veprim që cënon zgjedhjet si: votimi pa kryer identifikimin elektronik, kanosja, falsifikimi apo dëmtimi i materialit zgjedhor	<b>NGA 3 MUAJ - 7 VITE BURG</b>

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

#### **Periudha e publikimit:**

Janar – 14 Maj

#### **Mediat online ku do të publikohen:**

Të gjitha mediat online më të ndjekura!

#### ***D. Rrjete Sociale***

#### **Përmbajtja Baner/ poster**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Republikën e Shqipërisë. Zgjedhës shqiptarë votoni për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak, por kujdes përbën veprë penale dhe dënohet me burg:

VEPËR PENALE	DËNOHET
Fotografimi apo filmimi i votës, që ta shfaqësh tek persona të tjerë	<b>NGA 3 MUAJ - 3 VITE BURG</b>
Shitja dhe blerja e votës	<b>NGA 1-5 VITE BURG</b>
Votimi familjar, apo më shumë se një herë	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Çdo veprim që cënon zgjedhjet si: votimi pa kryer identifikimin elektronik, kanosja, falsifikimi apo dëmtimi i materialit zgjedhor	<b>NGA 3 MUAJ - 7 VITE BURG</b>

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

**Periudha e publikimit:**

Janar – 14 Maj

**Media sociale ku do të publikohen**

Të gjitha mediat sociale më të ndjekura!

***E. Materiale Promocionale***

**Përmbajtja**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Republikën e Shqipërisë. Zgjedhës shqiptarë votoni për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak, por kujdes përbën veprë penale dhe dënohet me burg:

<b>VEPËR PENALE</b>	<b>DËNOHET</b>
Fotografimi apo filmimi i votës, që ta shfaqësh tek persona të tjerë	<b>NGA 3 MUAJ - 3 VITE BURG</b>
Shitja dhe blerja e votës	<b>NGA 1-5 VITE BURG</b>
Votimi familjar, apo më shumë se një herë	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Çdo veprim që cënon zgjedhjet si: votimi pa kryer identifikimin elektronik, kanosja, falsifikimi apo dëmtimi i materialit zgjedhor	<b>NGA 3 MUAJ - 7 VITE BURG</b>

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

Lloji i materialeve promocionale që të përdoren:

1. Postera
2. City light
3. Fletëpalosje
4. Ekspozitë në rrugë

**Materiale që do të përdoren për edukimin e zgjedhësve**

- Postera format B2 informues, letër me lustër, shtypi 4 color
- Fletëpalosje format A3 me letër me lustër, shtypi 4 color
- Fletëpalosje format 85 x 400 mm letër me lustër, shtypi 4 color
- City - light



## PJESA E KATËRT

Ndërgjegjësimi i grupeve të targetuara, votues për herë të parë, minoritetet, gratë, për pjesëmarrje në votime.

### 1) Qëllimi:

Ndërgjegjësimi i grupeve vulnerabël dhe të rinjve votues për herë të parë për pjesëmarrje. Ky program ka në fokus ndërgjegjësimin e zgjedhëseve gra për të shmangur fenomenin negativ të votimit familjar në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar dhe të pandikuar, votuesit për herë të parë, personat me aftësi ndryshe, minoritetet për të rritur pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje.

### Mjetet:

- A. Spote televizive
- B. Krijimi i një video animimi (lojë)
- C. Media online
- D. Rrjete sociale
- E. Materiale promocionale

### A. Spotet Televizive

#### **Spoti për votuesit për here të parë**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Shqipëri.

Çdo shtetas që ka mbushur moshën 18 vjeç qoftë edhe ditën e zgjedhjeve ka të drejtën e ushtrimit të votës.

**Shënim:** Spoti 1 është konceptuar në formë video-mesazhi, ku disa të rinj do të japin mesazhin e tyre rreth përvojës së votimit dhe do të sesibilizojnë bashkëmoshatarët për pjesëmarrje në votime.

**Shënim:** Spoti 2 është konceptuar në formën e bashkëbisedimit duke përfshirë reklamimin e lojës që do të krijohet. Loja është menduar që do të jetë në formatin e mbledhjes së fletëve të votimit nëpërmjet levizjes së telefonit.

#### **Spoti për ndërgjegjësimin e grave**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Shqipëri.

- Unë jam grua njëlloj si ty.
- Voto që zëri yt të dëgjohet.
- etj

**Shënim:** Spoti është menduar në formatin e dhënies së një mesazhi të shkurtër nga gra me profesione të ndryshme si, police, infermiere, dokoresh, gardiane, balerinë, kengëtare, aktore, pianiste, etj.

### **Spoti për personat me aftësi ndryshe**

- Aftësia ndryshe nuk është pengesë për të votuar
- Nëse je i verbër voto vetë me maskën me alfabetin brail
- Nëse kërkon ndihmë për të votuar, mund t'ju ndihmojë një i afërm apo një zgjedhës i regjistruar në të njëjtën qendër votimi, parashikuar në nenin 108 të Kodit Zgjedhor.
- Në çdo qendër votimi do të ketë dhomë fshehtësie të përshtatur për ju

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

### **Spoti për minoritetet**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Shqipëri.

Çdo shtetas në Shqipëri ka të drejtën e plotë për të zgjedhur përfaqësuesin e tij. Ndaj dhe ju, e keni këtë mundësi. Drejtoheni në Qendrën e Votimit.....

**Shënim:** Spoti është menduar në formatin e dhënies së një mesazhi të shkurtër nga përfaqësues së minoriteteve në Shqipëri, dhe nga 1-2 pjesëtar nga secili minoritet.

Kohëzgjatja e spotit 50-60 sekonda.

### **Periudha e transmetimit**

Janar- 14 Maj

### **TV ku do të transmetohet**

Në kanalet e RTSH-së dedikuar për këto target grupe, media online/sociale.

### **Periudha e publikimit;**

Janar – 14 Maj

### **Media sociale ku do të publikohen**

Të gjitha mediat sociale më të ndjekura!

#### ***B. Materiale Promocionale***

1. Fletëpalosje
2. 3D mapping

### **Materiale që do të përdoren për edukimin e zgjedhësve**

- Fletëpalosje format A3 me letër me lustër, shtypi 4 color
- Fletëpalosje format 85 x 400 mm letër me lustër, shtypi 4 color

- 3D mapping – XXXXXXXX
- Shfaqja në ekranet LED
- Prodhim spoti dhe trasmetimi

## PJESA E PESTË

Financimi i partive politike dhe zbatimi i legjislacionit

### **Qëllimi:**

1) Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut për të denoncuar shkeljet që konstatojnë në lidhje me financimin e subjekteve zgjedhore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka autoritetin dhe përgjegjësinë të mbikqyrë, të kontrollojë dhe të auditojë fondet e fituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, gjatë dhe jashtë periudhës së fushatës zgjedhore. Ndryshimet e fundit në kuadrin ligjor synojnë të rrisin transparencën financiare dhe mbikëqyrjen e fushatave zgjedhore.

### **2) Mjetet:**

- A. Spote televizive
- B. Media online
- C. Rrjete sociale
- D. Materiale promocionale

#### *A. Spotet Televizive*

### **Përmbajtja**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Republikën e Shqipërisë.

- Subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre mund të marrin fonde për qëllime të fushatës zgjedhore vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas.
- Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë, këtu përfshihen edhe sende, ose shërbime.
- Ndalohet që Subjektet Zgjedhore dhe kandidatët të marrin fonde nga një person juridik apo çdo aksioner i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:
  - a) ka përfutuar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 3 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë.*

*b) ushtron veprimtari në fushën e medias;*

*c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;*

*ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.*

- Personat fizikë ose juridikë, që kanë bërë dhurime për subjekte zgjedhore, nuk mund të përfitojnë për 3 vjet pas zgjedhjeve asnjë kontrata që tejkalon shumën prej 10 milionë lekësh.
- Subjekti zgjedhor është i detyruar të bëjë publike dhurimet, huatë ose kreditë e përfituara për të gjitha vlerat e barabarta dhe më të larta se 50 mijë lekë.
- Për çdo shkelje, KQZ ka vënë në dispozicion portalin zyrtar në internet me akses të plotë për të denoncuar çdo rast paligjshmërie nga Subjektet Zgjedhore, apo kandidatët.

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

Kohëzgjatja e spotit 50-60 sekonda

### **Periudha e transmetimit;**

Janar - Shkurt

### **TV ku do të transmetohet;**

Në të gjitha TV e licencuar nga AMA (kombëtare/lokale)

## ***B. Media Online / rrjetet sociale***

### **Përmbajtja spotit / baner-poster**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Republikën e Shqipërisë.

- Subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre mund të marrin fonde për qëllime të fushatës zgjedhore vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas.
- Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë, këtu përfshihen edhe sende, ose shërbime.
- Ndalohet që Subjektet Zgjedhore dhe kandidatët të marrin fonde nga një person juridik apo çdo aksioner i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

*a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 3 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë.*

*b) ushtron veprimtari në fushën e medias;*

*c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;*

ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

- Personat fizikë ose juridikë, që kanë bërë dhurime për subjekte zgjedhore, nuk mund të përfitojnë për 3 vjet pas zgjedhjeve asnjë kontrata që tejkalon shumën prej 10 milionë lekësh.
- Subjekti zgjedhor është i detyruar të bëjë publike dhurimet, huatë ose kreditë e përfituara për të gjitha vlerat e barabarta dhe më të larta se 50 mijë lekë.
- Për çdo shkelje, KQZ ka vënë në dispozicion portalin zyrtar në internet me akses të plotë për të denoncuar çdo rast paligjshmërie nga Subjektet Zgjedhore, apo kandidatët.

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

### **Periudha e publikimit;**

Janar - Prill

### **Mediat online ku do të publikohen;**

Të gjitha mediat online më të ndjekura dhe rrjetet sociale!

### ***C. Materiale promociionale***

**Lloji i materialeve promociionale që të përdorën do të kenë të njejtën përmbajtje si me sipër dhe janë:**

1. Postera
2. Fletëpalosje

### **Materiale që do të përdoren për edukimin e zgjedhësve**

- Postera format B2 informues, letër me lustër, shtypi 4 color
- Fletëpalosje format A3 me letër me lustër, shtypi 4 color
- Fletëpalosje format 85 x 400 mm letër me lustër, shtypi 4 color
- Prodhim spoti
- Trasmetimi në tv dhe media online

## PJESA E GJASHTË

Informimi i administratës publike për ndalimet dhe kriteret ligjore për zgjedhjet.

### 1) Qëllimi:

Ndërgjegjësimi i punonjësve të administratës shtetërore gjatë periudhës zgjedhore dhe informimi mbi shkeljet ligjore dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre, si dhe raportimi i çdo rasti në portalin e dedikuar për monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të Burimeve Njerëzore, Financiare dhe Logjistike para zgjedhjeve.

### 2) Mjetet:

- A. Spote televizive
- B. Spote radiofonike
- C. Media online
- D. Rrjete sociale
- E. Materiale promocionale

#### A. Spote televizive

### Përmbajtja

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Republikën e Shqipërisë. Përbën veprë penal dhe dënohet:

VEPËR PENALE	DËNOHET
Pjesëmarrja e një punonjësi të administratës shtetërore në aktivitete ose fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Detyrimi ose organizimi i nxënësve të arsimit parauniversitar për të marrë pjesë në fushatë nga punonjës në arsimin publik dhe jopublik	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Detyrimi ose kërkesa nga punonjës që kryen një detyrë shtetërore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore, ose për të votuar në një mënyrë caktuar	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një subjekti zgjedhor	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Shpërdorimi i autoritetit ushtarak për të influencuar në votime tek ushtarakët e tjerë me dhënie urdhërash, apo çdo propagande tek vartësit	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Shpërdorimi i autoritetit policor nga punonjësi i Policisë së Shtetit ose i Policisë së Burgjeve për të influencuar në votime me dhënien e urdhrave, apo çdo propagande tek vartësit	<b>NGA 1-5 VITE BURG</b>

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

Kohëzgjatja e spotit 45 sekonda.

### **Periudha e transmetimit**

Janar - Shkurt

### **TV ku do të transmetohet**

Në të gjitha tv e licensuar nga AMA (kombëtare/lokale), media sociale.

### ***B. Spote radiofonike***

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Republikën e Shqipërisë. Përbën vepër penale dhe dënohet:

<b>VEPËR PENALE</b>	<b>DËNOHET</b>
Pjesëmarrja e një punonjësi të administratës shtetërore në aktivitete ose fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Detyrimi ose organizimi i nxënësve të arsimit parauniversitar për të marrë pjesë në fushatë nga punonjës në arsimin publik dhe jopublik	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Detyrimi ose kërkesa nga punonjës që kryen një detyrë shtetërore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore, ose për të votuar në një mënyrë caktuar	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një subjekti zgjedhor	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Shpërdorimi i autoritetit ushtarak për të influencuar në votime tek ushtarakët e tjerë me dhënie urdhërash, apo çdo propagande tek vartësit	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Shpërdorimi i autoritetit policor nga punonjësi i Policisë së Shtetit ose i Policisë së Burgjeve për të influencuar në votime me dhënien e urdhrave, apo çdo propagande tek vartësit	<b>NGA 1-5 VITE BURG</b>

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

Kohëzgjatja e spotit 50-60 sekonda.

### **Periudha e transmetimit**

Mars - Prill

### **TV ku do të transmetohet**

Në të gjitha tv e licensuar nga AMA (kombëtare/lokale), media sociale, app të ndryshme teknologjike.

### ***C. Media Online***



Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Republikën e Shqipërisë. Përbën vepër penale dhe dënohet:

VEPËR PENALE	DËNOHET
Pjesëmarrja e një punonjësi të administratës shtetërore në aktivitete ose fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Detyrimi ose organizimi i nxënësve të arsimit parauniversitar për të marrë pjesë në fushatë nga punonjës në arsimin publik dhe jopublik	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Detyrimi ose kërkesa nga punonjës që kryen një detyrë shtetërore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore, ose për të votuar në një mënyrë caktuar	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një subjekti zgjedhor	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Shpërdorimi i autoritetit ushtarak për të influencuar në votime tek ushtarakët e tjerë me dhënie urdhërash, apo çdo propagande tek vartësit	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Shpërdorimi i autoritetit policor nga punonjësi i Policisë së Shtetit ose i Policisë së Burgjeve për të influencuar në votime me dhënien e urdhrave, apo çdo propagande tek vartësit	<b>NGA 1-5 VITE BURG</b>

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

Kohëzgjatja e spotit 30 sekonda

**Periudha e transmetimit:**

Janar – 14 Maj

**Radio ku do të transmetohet:**

Në të gjitha radiot e licencuar nga AMA (kombëtare/lokale)

***D. Rrjete Sociale***

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Republikën e Shqipërisë. Përbën vepër penal dhe dënohet:

VEPËR PENALE	DËNOHET
Pjesëmarrja e një punonjësi të administratës shtetërore në aktivitete ose fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Detyrimi ose organizimi i nxënësve të arsimit parauniversitar për të marrë pjesë në fushatë nga punonjës në arsimin publik dhe jopublik	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Detyrimi ose kërkesa nga punonjës që kryen një detyrë shtetërore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore, ose për të votuar në një mënyrë caktuar	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>





Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një subjekti zgjedhor	<b>NGA 1-3 VITE BURG</b>
Shpërdorimi i autoritetit ushtarak për të influencuar në votime tek ushtarakët e tjerë me dhënie urdhërash, apo çdo propagande tek vartësit	<b>NGA 6 MUAJ-3 VITE BURG</b>
Shpërdorimi i autoritetit policor nga punonjësi i Policisë së Shtetit ose i Policisë së Burgjeve për të influencuar në votime me dhënien e urdhrave, apo çdo propagande tek vartësit	<b>NGA 1-5 VITE BURG</b>

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

### **Periudha e publikimit:**

Janar – 14 Maj

### **Media sociale ku do të publikohen**

Të gjitha mediat sociale më të ndjekura!

#### ***E. Materiale promociionale/Postera për Qendrat e Votimit.***

1. Postera
2. Fletëpalosje
3. Fletëpalosje
4. Gazetat
5. City - light
6. Billboard

### **Materiale që do të përdoren për edukimin e zgjedhësve**

- Postera format B2 informues, letër me lustër, shtypi 4 color - 35 lek copa
- Fletëpalosje format A3 me letër me lustër, shtypi 4 color - 35 lek copa
- Fletëpalosje format 85 x 400 mm letër me lustër, shtypi 4 color - 35 lek copa
- Gazetat, ½ e faqes së brendshme referuar ofertave të gazetave
- City - light
- Billboard
- Prodhim spotesh tv/ media online
- Trasmetim

## PJESA E SHTATË

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit në procesin e votimit dhe mbi mënyrën e votimit;

### 1) Qëllimi:

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit në procesin e votimit dhe mbi mënyrën e votimit, hapat që ndjek zgjedhësi në QV së bashku me identifikimin elektronik të zgjedhësve në Qendrat e Votimit.

### 2) Mjetet:

- A. Spote televizive
- B. Media online
- C. Rrjete sociale
- D. Materiale promociionale

### *A. Spotet Televizive*

### Përmbajtja

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Shqipëri.

- Qendrat e votimit do të jenë hapur nga ora 07.00 deri në orën 19.00. Do të votojë edhe personi i fundit që pret në radhë.
- Nëse karta apo pasaporta ju kanë skaduar, ju nuk mund të votoni!
- Identiteti juaj do verifikohet nga pajisja elektronike, brenda qendrës ku ju votoni.
- Pas identifikimit elektronik merr fletën e votimit dhe sigurohu që ajo të jetë e vulosur.
- Në zgjedhjet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak, votohet me dy fletë votimi.
- Hyj i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletat e votimit shëno shenjën X ose +, në krah të emrit të kandidatit të subjektit zgjedhor, apo partisë pjestare të një koalicioni,
- Dilni nga dhoma e fshehtë me fletat e votimit të palosura, ku njëra nga vulat në pjesën e pasme të saj të jetë e dukshme.
- Hidhni fletat e votimit në kuti.
- Largohu nga qendra e votimit.

***Të dhënat tuaja personale do të ruhen dhe përpunohen sipas standardeve më të larta të Sigurisë bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi.***

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

Kohëzgjatja e spotit 50-60 sekonda.

### **Periudha e transmetimit**

Mars - Prill

### **TV ku do të transmetohet**

Në të gjitha tv e licënuar nga AMA (kombëtare/lokale), media sociale, app të ndryshme teknologjike.

## ***B. Media online***

### **Përmbajtja**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Shqipëri.

- Qendrat e votimit do të jenë hapur nga ora 07.00 deri në orën 19.00. Do të votojë edhe personi i fundit që pret në radhë.
- Nëse karta apo pasaporta ju kanë skaduar, ju nuk mund të votoni!
- Identiteti juaj do verifikohet nga pajisja elektronike, brenda qendrës ku ju votoni.
- Pas identifikimit elektronik merr fletën e votimit dhe sigurohu që ajo të jetë e vulosur.
- Në zgjedhjet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak, votohet me dy fletë votimi.
- Hyj i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletat e votimit shëno shenjën X ose +, në krah të emrit të kandidatit të subjektit zgjedhor, apo partisë pjestare të një koalicioni,
- Dilni nga dhoma e fshehtë me fletat e votimit të palosura, ku njëra nga vulat në pjesën e pasme të saj të jetë e dukshme.
- Hidhni fletat e votimit në kuti.
- Largohu nga qendra e votimit.

***Të dhënat tuaja personale do të ruhen dhe përpunohen sipas standardeve më të larta të Sigurisë bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi.***

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

### **Periudha e publikimit;**

Janar - Mars

### **Mediat online ku do të publikohen;**

Të gjitha mediat online më të ndjekura!



### ***C. Rrjete sociale***

#### **Përmbajtja**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Shqipëri.

- Qendrat e votimit do të jenë hapur nga ora 07.00 deri në orën 19.00. Do të votojë edhe personi i fundit që pret në radhë.
- Nëse karta apo pasaporta ju kanë skaduar, ju nuk mund të votoni!
- Identiteti juaj do verifikohet nga pajisja elektronike, brenda qendrës ku ju votoni.
- Pas identifikimit elektronik merr fletën e votimit dhe sigurohu që ajo të jetë e vulosur.
- Në zgjedhjet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak, votohet me dy fletë votimi.
- Hyj i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletat e votimit shëno shenjën X ose +, në krah të emrit të kandidatit të subjektit zgjedhor, apo partisë pjestare të një koalicioni,
- Dilni nga dhoma e fshehtë me fletat e votimit të palosura, ku njëra nga vulat në pjesën e pasme të saj të jetë e dukshme.
- Hidhni fletat e votimit në kuti.
- Largohu nga qendra e votimit.

***Të dhënat tuaja personale do të ruhen dhe përpunohen sipas standardeve më të larta të Sigurisë bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi.***

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

#### **Periudha e publikimit:**

Janar – 14 Maj

#### **Media sociale ku do të publikohen**

Të gjitha mediat sociale më të ndjekura!

## ***E. Materiale Promocionale***

### **Përmbajtja**

Në 14 Maj 2023 votohet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak në Shqipëri.

- Qendrat e votimit do të jenë hapur nga ora 07.00 deri në orën 19.00. Do të votojë edhe personi i fundit që pret në radhë.
- Nëse karta apo pasaporta ju kanë skaduar, ju nuk mund të votoni!
- Identiteti juaj do verifikohet nga pajisja elektronike, brenda qendrës ku ju votoni.
- Pas identifikimit elektronik merr fletën e votimit dhe sigurohu që ajo të jetë e vulosur.
- Në zgjedhjet për Kryetar Bashkie dhe Këshilla Bashkiak, votohet me dy fletë votimi.
- Hyj i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletat e votimit shëno shenjën X ose +, në krah të emrit të kandidatit të subjektit zgjedhor, apo partisë pjestare të një koalicioni,
- Dilni nga dhoma e fshehtë me fletat e votimit të palosura, ku njëra nga vulat në pjesën e pasme të saj të jetë e dukshme.
- Hidhni fletat e votimit në kuti.
- Largohu nga qendra e votimit.

***Të dhënat tuaja personale do të ruhen dhe përpunohen sipas standardeve më të larta të Sigurisë bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi.***

Për më shumë informacion shkarkoni aplikacionin mobile **KQZ** Android/IOS, ose vizito website [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al).

Lloji i materialeve promocionale që të përdoren:

1. Postera për qendrat e votimit
2. Fletëpalosje
3. City – light

### **Materiale që do të përdoren për edukimin e zgjedhësve**

- Postera format B2 informues, letër me lustër, shtypi 4 color
- Fletëpalosje format A3 me letër me lustër, shtypi 4 color
- Fletëpalosje format 85 x 400 mm letër me lustër, shtypi 4 color
- City - light
- Prodhim spotesh tv/media sociale/online
- Trasmetim spotesh tv/ media sociale/online

## PJESA E TETË

### 1) Qëllimi:

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj. Zgjedhësit të jenë të përgatitur ditën e votimit për plotësimin e fletës së votimit që vota e tyre të jetë e vlefshme. Fushata për plotësimin e fletës së votimit do të jetë intensive 2 apo 3 javët e fundit para datës së zgjedhjeve.

### 2) Mjetet:

- A. Spote televizive
- B. Media online
- C. Rrjete sociale
- D. Materiale promocionale

#### *Spotet Televizive*

Përmbajtja për tu përcaktuar

#### *Perjudha e trasmetimit*

*Janar- Prill (rreth 1 muaj në varësi të vendimit për modelin e fletës së votimit)*